



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Vazhdon modernizimi i Shërbimit Parësor Shëndetësor

2018-01-09 14:15:00



Lapraka, njësi administrative e Tiranës me 70 mijë banorë, ka tashmë një Qendër Shëndetësore të standardeve bashkëkohore, ku ka nisur të funksionojë edhe sistemi i referimit elektronik. Me anë të një financimi prej 230 mijë eurosh, falë bashkëpunimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Save the Children, kjo qendër është zgjeruar dhe pajisur me aparaturat e nevojshme, duke sjellë edhe shërbime të reja deri dje jashtë kushteve minimale, siç shërbimi i konsultorit të fëmijëve, tek shërbimet obstetrike-gjinekologjike dhe ndjekjes së fëmijës. Qendra është pajisur për herë të parë edhe me aparatura të reja dhe mjetet obstetrike-gjinekologjike bashkëkohore, të cilat mungonin krejtësisht. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, inspektuan Qendrën e re.

“Është një qendër që ofron edhe shërbime plus për nënën dhe për gruan shtatzënë. Kemi një eko të re, e cila është instaluar pranë kësaj qendre, nuk ka qenë më parë dhe sigurisht, një shërbim i ri që ofrohet për nënën gjatë ndjekjes së shtatzënisë, por gjithashtu kushte e standarde bashkëkohore për ndjekjen e fëmijës,” u shpreh ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu. “Kanë qenë 3 mjekë dhe 7 infermiere në një dhomë dhe aneks. Tre mjekë vizitonin, plus vaksinimi në atë dhomë. Ka qenë në kushte shumë të vështira. Është diametralisht e kundërt dhe me standarde shumë bashkëkohore dhe me të gjitha pajisjet e domosdoshme për një specialist,” shprehet mjeku i Qendrës.

“Ky shërbim është për herë të parë në poliklinikën tonë. Nuk e kemi pasur më përpara eko gjinekologjike dhe obstetrikale, plus eko gjinekologjike për urgjencat e ndryshme, që është edhe portative për rastet urgjente që mund të ketë ndonjë grua shtatzënë, mund ta ekzaminojmë në shtëpi,” deklaroi mjekja gjinekologe.

Sistemi i referimit elektronik për shërbimin te mjeku specialist lehtëson shërbimin nga burokracitë. Edhe në këtë qendër, sikurse në 36 qendrat shëndetësore të Tiranës dhe rrethinave, si dhe në 4 poliklinikat e specialiteteve në Tiranë, ka nisur të funksionojë ky sistem i ri, i cili mundëson që vizita te mjeku specialist të rezervohet online për pacientin nga mjeku i familjes dhe nuk do të jetë më e nevojshme që pacienti të sorollatet me letra në dorë e vula pa fund për të kryer një vizitë të specializuar.

“Në të 36 qendrat shëndetësore në Tiranë dhe në 4 poliklinikat e specialiteteve, për herë të parë kemi përfshirë një sistem të ri, referimin elektronik dhe ekzaminimin elektronik. Tani qytetarët shmangin radhët e gjata të pritjes te mjeku specialist, duke vendosur nëpërmjet sistemit elektronik orën, datën e vizitës. Sigurisht ndihmon mjekët për të pasur arkivimin e të gjithë diagnozës së pacientit dhe shërbimet që ofron,” deklaroi ministrja Manastirliu. “Pacienti paraqitet me kartën e shëndetit. Në momentin që futet ID dalin të dhënat e pacientit. Shkruajnë të gjitha ankesat e

pacientit, institucionin në të cilën zgjidhet, siç është në rastin tonë poliklinika e specialiteteve Nr. 3, zgjidhet specialisti alergolog dhe pyetet pacienti për ditën dhe orën kur e do,” shpjegon funksionimin e sistemit mjekja e Qendrës.

Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore është parësore për ofrimin e shërbimit me standardet që meritojnë qytetarët.

“Është e vetmja rrugë që të lehtësohet i gjithë shërbimi në spitale dhe që të ndahet shërbimi parësor me nevojat e menjëhershme të njerëzve me shërbim më të specializuar, pastaj në qendrat e mëdha spitalore. Ndryshe do ishte e pamundur që të bëhet edhe njëra dhe tjetra dhe s’bëhet tamam as njëra as tjetra. 300 qendra do bëjmë në këto 4 vjet,” deklaroi Kryeministri Edi Rama.

“Ne kemi filluar programin e investimit në 300 qendra shëndetësore në 4 vite. Këtë vit fillojmë 80 qendrat e para në të gjithë Shqipërinë, në mënyrë që qendrat shëndetësore, që janë dhe porta e parë e shërbimit për qytetarët, të kenë standarde dhe kushte sa më të mira dhe një gamë e larmi shërbimesh për qytetarët” u shpreh Manastirliu.